



### Komiteti për shëndetësi dhe përkujdesje sociale

#### PROCESVERBAL

Mbledhja e komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale është mbajtur me datë **28.10.2022** (e premte) me fillim në ora **08:30**. Mbledhjen e dytë e kryesoi kryesuesja **Vlora Vuçitërna Çmega**.

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend dite;

#### REND DITE

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Të ndryshme;
3. Vizitë në qendrën kryesore të mjekësisë familjare (QKMF) në Rahovec;

**Kryesuesja** – Atëherë përshëndetje për të gjithë. Mirë se keni ardhur në mbledhjen e dytë të komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale.

Pa humbur kohë e vendosim në votim rendin e ditës. Kush është për?... Me të gjitha votat pro aprovohet rendi i ditës.

#### 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

**Kryesuesja** – A ka dikush ndonjë vërejtje rreth procesverbalit të mbledhjes së kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me të gjitha votat pro kalon edhe pikja e parë e rendit të ditës.

#### 2. Të ndryshme;

A ka dikush ndonjë gjë për diskutim?

**Edmond Kabashi** – Përshëndetje, a është i njoftuar drejtori i QKMF-së për vizitën që do ta bëjmë atje?...

**Kryesuesja** – Po Edmond, drejtorin e kemi njoftuar.

**Lirëzoni Kasstrati** – Përshëndetje kryesuese, anëtarë të këtij komiteti, sekretari e kuvendit. Kishte me qenë mirë që në njërin prej mbledhjeve tona të diskutohet një plan sa i përket punës së komitetit dhe të ceket se cilat do të jenë vizitat tona të ardhshme.

#### 3. Vizitë në qendrën kryesore të mjekësisë familjare në Rahovec;

**Edmond Kabashi** - Përshëndetje për të gjithë. Si vizitë shpresë është mirë dhe duhet ta bëjmë në qendër për punë sociale në Rahovec. Ta shohim situatën dhe rrjedhën e punës atje.

**Kryesuesja** - Faleminderit të gjithëve. Atëherë vizita në QKMF do të realizohet prej orës 9:00 me crast drejtori na pret në po të njëjtën orë.

Atëherë nëse nuk ka dikush diçka tjetër për diskutim, po e përfundojmë mbledhjen, ritakohemi në mbledhjen tjetër.

Mbledhja ka përfunduar në ora 08:50

Procesmbajtësi;

Albion Krasniqi

